AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Nëntor 2023

28.12.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin nentor 2023.

Deficit tregtar është më i lartë për (28.8%) në muajin nëntor 2023, krahasuar me nëntor 2022

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të larët për (28.8%) në muajin nëntor 2023, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2022, gjegjësisht në vlerë prej 517,3 milion euro krahasuar me deficitin 401,5 milion euro në vitin 2022. Eksporti mbulon importin (12.9%).

Eksporti i mallrave në muajin nëntor 2023 kishte vlerën 76,5 milion euro, ndërsa importi 593,8 milion euro, është një rritje prej (3.4%) për eksport si dhe rritje prej (24.9%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Grafikomi në vijim paraqet qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme



Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit e përbëjnë: (23.4%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (17.2%) artikuj të ndryshëm të prodhuar, (13.9%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (10.7%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (3.0%) produkte minerale, etj.

Grafikoni në vijim paraqet eksportet sipas seksioneve të grupeve kryesor në vlerë



Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesor për import e përbëjnë: (12.7%) produktet minerale, (10.6%) makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, (10.3%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (10.1%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (8.8%) mjetet e transportit, (6.2%) produkte të industrisë kimike, (4.8%) plastikë,gomë dhe artikuj prej tyre, etj.



Tabela paraqet eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe në përqindje

(në mijë Euro)

Vendet	Nëntor- 2022		Nëntor - 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	**73,955**	**100.0**	**76,500**	**100.0**
27 vendet e BE_së	25,547	43.7	29,261	33.5
Cefta	26,218	33.1	27,657	38.8
Të tjera	22,190	23.2	19,581	27.7
	Importet (CIF)			
Gjithsej	**475,419**	**100.0**	**593,782**	**100.0**
27 vendet e BE_së	204,869	41.6	228,092	44.3
Cefta	86,454	17.0	75,967	15.4
Të tjera	184,096	41.4	289,723	40.3

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 29,3 milion euro, ose rreth (38.3%) e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (14.5%). Partneret kryesor për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (11.0%), Austria (6.6%), Italia (5.1%), Holanda (3.4%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 228,1 milion euro, ose (38.4%) e importeve të përgjithshme, me një rritje prej (11.3%). Importet me pjesmarje me të lartë ishin nga: Gjermania (11.1%), Greqia (6.2%), Italia (4.3%), etj

Në muajin nëntor 2023, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 27,7 milion euro, ose (36.2%) të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (5.5%). Partner kryesor për eksport nga vendet e CEFTA-së janë: Maqedonia e Veriut (12.9%), Shqipëria (12.4%), Sërbia (4.9%), Mali i zi (4.6%).
Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-së në muajin nëntor 2023, arritën në 76,0 milion euro, ose (12,8%) të importeve të përgjithshme, me një rënje prej (12.1%). Vendet me pjesmarje më të lartë për import ishin: Shqipëria (5.2%), Maqedonia e Veriut (4.6%), Serbia (1.9%).

Eksportet e Kosovës me vendet tjera arritën në 29,6 milion euro, ose (25.6%). Si partner më të rëndësishëm nga këto vendet për eksport vlen të përmendën: SHBA (10.5%), dhe Zvicra (8.8%).
Ndërsa importet e Kosovës me vendet tjera arritën në 289,7 milion euro, ose (48.8%). Vendet me pjesmarje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (24.7%), dhe Kina (11.4%).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin nentor 2023, vizitoni:
http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/tregtia-e-jashtme
https://ask.rks-gov.net/Releases